

UNIVERSITETI I PRISHTINES

FAKULTETI EKONOMIK

Syllabus

LËNDA: VENDOSJA NE BIZNES

Studimet : Bachelor

Qëllimi i Kursit

Lënda Vendosja ne Biznes është dizajnuar që t'i familjarizojë studentët me konceptet fundamentale të teorisë dhe metodave të vendosjes në biznesin bashkëkohor. Qëllim kryesor i këtij moduli është që t'i aftësojë studentët t'i aplikojnë në mënyrë efektive dijet e fituara nga fushat e tjera në proceset vendimmarrëse duke u bazuar në praktikat bahskëhore të vendimmarjes menaxheriale në përputhje me kushtet dhe situatat e ndryshme të vendosjes.

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Arritja e një niveli solid të njohurive në fushën e teorisë së shkencës së vendosjes; që nënkupton pajisjen me njohuri mbi kuptimin dhe rolin e shkencës së vendosjes në botën bashkëkohore të biznesit dhe atë se si menaxherët bëjnë zgjedhje në një botë të pamjaftueshmërisë së resurseve. Studentët duhet të demonstrojnë aftësi në integrimin me sukses të dijeve në procesin e vendimmarrjes. Po ashtu studentët do të jenë të aftë të **aplikojnë** modelet e ndryshme vendimmarrjes dhe menaxhimit në situatë të caktuara të vendosjes në shpërndarjen e resurseve të rralla (inputeve) më qëllim të rritjes së profiti të ndërmarrjes.

Metodologjia e mësimdhënies:

Modull do të bazohet në ligjërata interaktive dhe në punë grupore të studentëve. Në çdo ligjëratë do të prezentohen konceptet dhe teknikat kyçe në vendimmarrje. Ndërsa në orë të ushtrimeve përmes rasteve studimore nga jeta e biznesit studentët do të inkurjohen në aplikimin e këtyre koncepteve dhe teknikave në zgjidhjen e problemeve në organizatë. Poashtu, studentëve do tu jepen detyra të cilat do të zgjidhin në shtëpi për çdo kapitull për t'i inkurajuar ata që të mësojnë dhe për të zhvilluar efektivisht ushtrimet seminarike në klasë. Detyrat do të prezantohen dhe diskutohen në klasë nga të gjithë studentët në frymën e një interaksioni produktiv, ku studentët do të mësojnë nga njeri tjetri me inputet e mësimdhënësit aty ku është e nevojshme.

Litaratura bazë që duhet ta përdorin studentët:

TITULLI	AUTORI	BOTUESI	DATA
Menaxhmenti dhe Vendosja	Dr. Ibrahim Kuka, Dr. Justina Shiroka-Pula, Mr. Besnik Krasniqi	Universiteti i Prishtinës	2006
Teoria dhe Metodat e Vendosjes Afariste	Dr. Ibrahim Kuka	Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest	1997

Litaratura shtesë / rekomanduar:

TITULLI	AUTORI	BOTUESI	DATA
---------	--------	---------	------

<i>Decision Making: An Integrated Approach</i>	Jennings D., and S. Wattam.	Pitman Publication	1998
<i>Whatever It Takes: The Realities of Managerial Decision Making,</i>	McCall M., and R. Kaplan	Prentice Hall	2001
<i>Management Science – Quantitative Approaches to Decision Making,</i>	Anderson, D, Sweeney, D and Williams, T.,	South-Western Coolage Publishing	2005
<i>Decision Making in Action: Models and Methods</i>	Klein G., et al., (Ed.),	Ablex Publication	1993

Plani i mësimit për një semestër:

Java e parë: Menaxhmenti dhe vendosja

Java e dytë: Teoritë e vendosjes

Java e tretë: Procesi i vendosjes

Java e katërt: Faktorët e vendosjes

Java e pestë: Prezentimet e punës së studentëve

Java e gjashtë: Testi 1

Java e shtatë: Menaxhmenti, lidershipi dhe vendosja

Java e tetë: Modelet e vendosjes

Java e nëntë: Vendosja individuale dhe grupore

Java e dhjetë: Problemet e vendosjes grupore

Java e njëmbëdhjetë: Teknikat e marrjes së vendimeve në grup

Java e dymbëdhjetë: Teoria e lojrave

Java e trembëdhjetë: Sistemi informatik dhe vendosja

Java e katërbëdhjetë: Prezentimi i punës së studentëve

Java e pesëmbdhjetë: Testi 2

Detyrat (aktivitetet e mësimit) të cilat do të vlerësohen në orët mësimore: